



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kaçanik**  
**Municipal Kaçanik**  
**-Kuvendi i Komunës-**

01Nr. *60/01-8920/24*  
Kaçanik, 29.04.2024

Në bazë të Vendimit të KQZ-së, Nr. 01/504-2024 të datës 13.04.2024, protokollit i komunës 01Nr. 60/01-8920/24 i datës 15.04.2024, me të cilin është caktuar Zëvendësimi i anëtarit të dorëhequr, Adnan Reka, me kandidatin e radhës nga po i njëjti subjekt politik LVV, Burim Shehu, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 29.04. 2024, i konstatohet:

**Ndryshim Plotësimin e Përbërjes së Kuvendit të Komunës Kaçanik  
të Legjislaturës së shtatë (7) të zgjedhur me 17 Tetor 2021**

- BURIM SHEHU** – nga subjekti politik “Lëvizja Vetëvendosje- LVV” sipas Vendimit të KQZ Nr. 01/504/2024 të datës 13.04.2024 (bashkangjitur kësaj shkrese) është emëruar, Anëtar (Këshilltar) i Kuvendit të Komunës Kaçanik, në vend të Anëtarit të dorëhequr të Kuvendit të Komunës Kaçanik, Adnan Reka.
- Betimin për Anëtar të Kuvendit të Komunës, Burim Shehu e ka dhënë në mbledhjen e Rregullt të Kuvendit të Komunës më datë: 29.04.2024. Nga kjo datë realizon të gjitha të drejtat dhe detyrat si anëtarët tjerë të Kuvendit të Komunës, përfshirë edhe çështjen e kompensimit.
- Anëtari i Kuvendit të Komunës Kaçanik nga pika 1 e kësaj shkrese, më rastin e dhënies së Betimit Solemn dhe nënshkrimit të Deklaratës Solemne, para Kuvendit të Komunës, u zotua se merr përsipër detyrat e anëtarit të Kuvendit Komunal të përcaktuara si në dispozitat e nenit 35.4 të LVL.
- Mandati i anëtarit të Kuvendit të Komunës është i lidhur më mandatin e Kuvendit të Komunës, fillon nga data e emërimit në këtë post, respektivisht pas dhënies së Betimit Solemn dhe nënshkrimit të Deklaratës Solemne për Anëtar të Kuvendit të Komunës Kaçanik, ndërsa përfundon sipas dispozitave të nenit 37.2 të LVL.
- Obligohen organet relevante të komunës t’i marrin veprimet e nevojshme për futjen në Listën e Pagave anëtarin e Kuvendit të Komunës, Burim Shehu dhe heqjen nga Lista e Pagave, anëtarin e dorëhequr, Adnan Reka.

**Me këtë shkresë njoftohen:** Kryetari i Komunës; Zyra e Personelit; Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli




I	Data 15.04.24	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë



01-60/01-2024

Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
 Centralna Izborna Komisija  
 Central Election Commission



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c) të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.3, nenin 6 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 13.04.2024, nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **Z.Burim Shehu**, emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Kaçanik, nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Adnan Reka.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Burim Shehu dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 11.04.2024, Nr.07/479/2024, për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal z.Adnan Reka, i cila ka dhënë dorëheqje, për arsye të angazhimeve tjera.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati i radhës në listën e rënditur është z.Burim Shehu.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë 13.04.2024

Kryesues  
 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
 Kreshnik Radoniqi

